



Viti i XVI-të i Botimit, Nr.1

Qershor 2024

## RREZIQET MË TË RËNDËSISHMIT PËR BANKAT NË SHQIPËRI

(RK, RPL, RR, RS)

Artur Ribaj\*, Manuela Kulla\*\*, Studente

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, Albanian University

### Abstrakt

Rreziku në veprimtarinë e bankave tregtare është një element që shoqëron në mënyrë të vazhdueshme veprimtarinë e tyre, si në çdo aktivitet tjetër biznesi. Ndryshimi mes bankave dhe bizneseve në aktivitete të tjera jashtë sistemit financiar është se në rastin e bankave, rreziqet e tyre kanë ndikim të drejtpërdrejtë në stabilitetin financiar të vendit dhe shtytjen (pozitivisht apo negativisht) që i japin ekonomisë së Shqipërisë, ndaj edhe risku që hasin ato në aktivitetin e tyre sjell efekte domino. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë si organ kushtetues ka përgjegjësinë të rregullojë, licencojë e mbikëqyrë aktivitetin e bankave në Republikën e Shqipërisë. Në ndihmë të plotësimit cilësor të kuadrit rregullator si për çdo vend tjetër, vijnë parimet Bazelit, direktivat e BE-së në kuadër të Acquis Coomunitare dhe praktikatat e mira. Nga analiza e literaturës dhe të dhënave nga pyetësori për 5 bankat kryesore në Shqipëri arritëm në konkluzionet se: rreziku i kredisë dhe rreziku reputacional janë më të rëndësishmit për bankat tregtare në Shqipëri.

**Fjalë kyçe:** *bankë tregtare; rreziku kredisë; rreziku reputacional; Banka e Shqipërisë*

### CREDIT RISK AND REPUTATIONAL RISK, THE MOST IMPORTANT FOR BANKS IN ALBANIA

#### Abstract

Risk in the activity of commercial banks is an element that constantly accompanies their activity, as in any other business activity. The difference between banks and businesses in other activities outside the financial system is that in the case of banks, their risks have a direct impact on the financial stability of the country and the push (positively or negatively) they give to Albania's economy, so also the risk they face those in their activity brings domino effects. For this reason, the Bank of Albania as a constitutional body has the responsibility to regulate, license and supervise the activity of banks in the Republic of Albania. The Basel principles, EU directives within the Acquis Coomunitare and good practices help to complete the regulatory framework qualitatively, as for any other country. From the analysis of the literature and data from the questionnaire for the 5 main banks in Albania, we reached the conclusions that: credit risk and reputational risk are the most important for commercial banks in Albania.

**Keywords:** *commercial bank; credit risk; reputational risk; Bank of Albania*

## 1 Hyrje

Ky punim përpiqet të sjellë në formë të përmbledhur zhvillimin e menaxhimit të riskut në institucionet financiare, me fokus në bankat tregtare në Shqipëri duke parë ato në një sfond historik të përmbledhur për evolucionin e menaxhimit të riskut. Analiza e literaturës në këtë punim është përqendruar kryesisht në literaturën e pas viteve 2008, duke pasur parasysh ndryshimet që solli kriza në qasjen ndaj vlerësimit të rrezikut të bankave. Banka e Shqipërisë me përgjegjësinë direkte për shëndetin financiar të bankave tregtare në Shqipëri gjatë këtyre dekadave ka kultivuar një qasje proaktive për azhornimin e kuadrit rregullator për mbikëqyrjen e aktivitetit bankar në Shqipëri. Por, si paraqitet zbatimi i kuadrit ligjor e rregullator është dilema kryesore për çdo pretendent të bankave në Shqipëri.

Prezantohet performanca e tregut bankar shqiptar e përditësuar deri në vitin 2023. Risqet kryesore të bankave tregtare jepen në rend prioritar, si edhe strategjitë që ndjekin ose mund të ndjekin ato për ta zvogëluar riskun. Në bazë të risqeve kryesore është përgatitur edhe një pyetësor, i shpërndarë në 5 bankat kryesore që zhvillojnë aktivitetin e tyre në Shqipëri. Përfundimet jepen tek analiza e rezultateve, ndërkohë që prezantohen edhe disa rekomandime, pavarësisht kufizimeve që sjell ky punim, si sasia e të anketuarve dhe subjektivizmi në përgjigjet e tyre.


Aktualisht, në Shqipëri veprojnë aktivitetin e tyre 11 banka tregtare, me kapital të huaj dhe vendas (BSH 2024). Sipas kronologjisë së regjistrimit të tyre kemi renditjen si në vijim: 1996 Banka Tirana sh.a.; 1998 Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a.; 1999 Banka Raiffeisen sh.a., Banka Amerikane e Investimeve sh.a.; Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a.; Banka Kombëtare Tregtare sh.a., Banka Procredit sh.a.; 2003 Banka Credins sh.a.; 2004 Banka OTP Albania sh.a.; 2006 Banka Union sh.a.; 2007 Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a. Gjatë dekadës së fundit janë larguar 5 banka nga Shqipëria (NBG, ALPHA Bank, Veneto Bank, Banka Ndërkombëtare Tregtare; Banka e Bashkuar).

**Tabela 1** Bankat tregtare shqiptare, sipas pronësisë dhe origjinës

	Banka Tregtare	Pronësia	Aksioneri		% e Aksioneve në Bankën		Vendi Origjinës Regjistri
			I huaj	Vendas	Të huaj	Vendas	
1	BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA	Kapitali i Huaj		Tranzit	0%	100%	Ishujt Cayman, Delaware
2	BANKA CREDINS	Kapital Vendas dhe i Huaj	B.F.S.E Holding B.V (15.10%)	Aleksandër Pilo (7.6%), ARMAAR GROUP (5.5%), Kristina Pilo (4.5%), Monika Milo (4.2%), A.F.C. (2.47%), PE - VLA - KUJ (2.92%), PRIMA (2.9%), Emi Santo (2.97%), Egj Santo (2.97%), Mattin Koruti (2.6%), Unioni Shqiptarë Krimine (2.6%), Dina	15.1%	84.9%	Shqipëri, Hollandë
3	BANKA E BASHKUAR E SHQJPERISE	Kapital Vendas dhe i Huaj	Islamic Development Bank (31.87%), Hamed H	EUROSIG SHA (66.26%)	33.74%	66.26%	Shqipëri, Arabi Saudite
4	Banka e Parë e Investimeve-Albania	Kapitali i Huaj	First Investment Bank AD		100%	0%	Bullgari
5	INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA	Kapitali i Huaj	Intesa SanPaolo		100%	0%	Itali
6	BANKA KOMBETARE TREGTARE	Kapitali i Huaj	ÇALIK HOLDING AMONIA SH.P.K		100%	0%	Turqi
7	Banka OTP Albania	Kapitali i Huaj	OTP Bank Nyrt		100%	0%	Hungari
8	ProCredit Bank	Kapitali i Huaj	Pro Credit Holding		100%	0%	Gjermani
9	RAIFFEISEN BANK SHA	Kapitali i Huaj	Raiffeisen SEE Region Holding		100%	0%	Austri
10	BANKA E TIRANES	Kapital Vendas		Balfin - Balkan Finance Investment UNIONI FINANCIAR TIRANE (96.46%),	0%	100%	Shqipëri
11	UNION BANK SHA	Kapital Vendas		EUROSIG SHA (96.46%),	0%	100%	Shqipëri


**Burimi:** QKB, Open Corporates Albania, tabela nga autorët

### Grafiku 1 Kapitali Bankar sipas Origjinës



Burimi: QKB, Open Corporates Albania, grafiku nga autorët

Tabela 2 Renditja e bankave sipas madhësisë së kapitalit në 31 janar 2023 (në lekë)



Burimi: QKB, Open Corporates Albania, - vizituar 16.02.2024, tabela nga autorët

Sipas të dhënave të marra nga SHSHB<sup>(1)</sup>, për kapitalin në 31 janar 2023, rezulton se totali asetëve për sistemin bankar shqiptar për totalin e asetëve arrin në 1.97 trilionë lekë.

## 2 Analiza e literaturës

Ky punim është përqendruar kryesisht në literaturën e pas viteve 2008 duke pasë në konsideratë ndryshimet që solli kriza në qasjen ndaj vlerësimit të rrezikut të bankave. Sipas studimit të Li, H., Sun, J., & Shan, J. (2010) heton ndikimin e praktikave të menaxhimit të riskut operacional në performancën e bankave në Kinë, duke përdorur një kampion të bankave tregtare. Autorët sugjerojnë se menaxhimi efektiv i riskut operacional ndikon pozitivisht në përfitueshmërinë dhe stabilitetin e bankës. Gündüz, Y., & Kaya, H. (2018) hulumtojnë ndërveprimet midis riskut të likuiditetit, riskut të kredisë dhe riskut të tregut në banka dhe rolin e rregullimit financiar në zbutjen e riskut sistematik. Ata diskutojnë ndërlidhjen e llojeve të ndryshme të riskut dhe propozojnë reforma rregullatore për të

1 ( ) Shoqata Shqiptare e Bankave – Të dhëna – Banking System Monthly bulletin – December 2023 <https://aab.al/te-dhena/>

përmirësuar praktikat e menaxhimit të riskut dhe për të ruajtur stabilitetin financiar. Për [Oet, M. V., Eiben, R., & Bianco, T. \(2018\)](#) objektivat dhe efektiviteti i ushtrimeve të testimit të stresit të bankës, me fokus në potencialin për kapjen rregullatore dhe konfliktet e interesit kanë rëndësi të veçantë. Ata rekomandojnë rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe pavarësisë në kornizat e testimit të stresit për të garantuar besueshmërinë dhe dobinë e tyre për stabilitetin financiar, ndërkohë që [Hull, J. C. \(2015\)](#) merret me lloje të ndryshme të risqeve me të cilat përballen bankat dhe ofron korniza teorike dhe shembuj të ilustruar konceptet e menaxhimit të riskut. Rekomandimet e [Dowd, K. \(2005\)](#) theksojnë rëndësinë e të kuptuarit të kufizimeve të teknikave të ndryshme të matjes së riskut dhe integritetin e qasjeve të ndryshme, ndërsa [Stiroh, K. J. \(2006\)](#) shqyrton përcaktorët e riskut bankar duke përdorur të dhëna nga bankat tregtare të SHBA-së gjatë periudhës 1985-2001. Ai rekomandon përmirësimin e kornizave të menaxhimit të riskut me rritjen e mbikëqyrjes rregullatore për të ruajtur stabilitetin financiar. [Allen, L., & Saunders, A. \(2011\)](#) merren me praktikat e menaxhimit të riskut të kredisë para dhe pas krizës financiare, duke u fokusuar në qasjet e reja të vlerës në risk (VaR). Ata shqyrtojnë ndikimin e ndryshimeve rregullatore dhe zhvillimet e tregut në modelimin dhe strategjitë e menaxhimit të riskut të kredisë. [Barth, J. R., Lin, C., Ma, Y., Seade, J., & Song, F. M. \(2013\)](#) merren me regullimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e efikasitetit bankar duke përdorur të dhëna nga një kampion bankash tregtare bankash. Ata sugjerojnë se regullimi dhe mbikëqyrja e rreptë mund të pengojnë fillimisht efikasitetin e bankës, por kornizat rregullatore efektive dhe praktikat mbikëqyrëse përfundimisht përmirësojnë performancën dhe stabilitetin afatgjatë të bankës.

Bankat tregtare përballen me një mori rreziqesh në operacionet e tyre, secila me ndikim në shëndetin e tyre financiar, reputacionin dhe aftësinë për të shërbyer klientëve. Disa nga risqet kryesore me të cilat bankat tregtare përballen dhe strategjitë të cilat ato zbatojnë për të zvogëluar këto risqe përfshijnë:

**Risku i kredisë.** Sipas Basel Committee on Banking Supervision, (2018), risku i kredisë buron nga mospërbushja në kohe e detyrimeve financiare të huamarrësve. Bankat përballen me riskun e mospagesës së kredisë, pagesave të vonuara ose uljes së kredisë, të cilat mund të çojnë në humbje financiare, ulje të cilësisë së aktiveve dhe ulje të fitimit. Menaxhimi efektiv i riskut të kredisë përfshin standarde të forta të nënshkrimit të kredisë, monitorim të vazhdueshëm të aftësisë paguese të huamarrësit, diversifikimin e portofolit të kredisë dhe krijimin e një fondi emergjent huaje, për të zvogëluar humbjet të mundshme nga kredia. Përhapja e investimeve nëpër klasa të ndryshme aktivesh dhe linja biznesi mund të ndihmojë në zbutjen e riskut të përqendrimit dhe zvogëlimin e ekspozimit ndaj kushteve të pafavorshme.

**Risku i tregut.** Risku i tregut përfshin humbjet e mundshme që vijnë nga lëvizjet jonormale në variablat e tregut si normat e interesit, normat e këmbimit valutor, çmimet e kapitalit dhe çmimet e mallrave. [Hull \(2018\)](#) thotë risqe se bankat me ekspozim portofoli të madh në tregti ose investime janë të ekspozuara ndaj riskut të tregut, i cili mund të ndikojë në vlerën e aktiveve, detyrimeve dhe pozicionit të tyre. Për të menaxhuar riskun e tregut, bankat përdorin strategji mbrojtëse, diversifikojnë investimet, në sektor apo tregje të ndryshme, kryejnë teste të stresit dhe vendosin kufij risku, për të zbutur ekspozimin ndaj paqëndrueshmërisë së tregut dhe për të ruajtur kapitalin.

**Risku i likuiditetit.** Risku i likuiditetit i referohet paaftësisë së një banke për të përmbushur detyrimet e saj afatshkurtra të financimit ose të nevojave për likuiditetin, pa shkaktuar kosto shtesë ose ndërprerje aktiviteti. Bankat përballen me riskun e likuiditetit kur nuk janë në gjendje të kenë burime të mjaftueshme financimi për të financuar operacionet e tyre ose për të përmbushur kërkesat për tërheqje të depozitave. Menaxhimi efektiv i riskut të likuiditetit përfshin ruajtjen e rezervave të përshtatshme të likuiditetit, diversifikimin e burimeve të financimit, menaxhimin e flukseve monetare dhe krijimin e planeve të financimit emergjent, për të siguruar qëndrueshmërinë e likuiditetit dhe pajtueshmërinë rregullatore (Bank for International Settlements, 2013).

**Risku operacional.** Risku operacional lind nga dështimet, gabimet ose ndërprerjet në proceset, sistemet, njerëzit ose ngjarjet apo faktirë e jashtë kontrollit të bankës. Këto mund të sjellin humbje finan-

ciare, ndërprerje operacionale, ndëshkime rregullatore dhe dëmtim të reputacionit. Risku operacional përfshin burime të ndryshme si gabimet njerëzore, dështimet e teknologjisë, mashtrimet, dështimet e pajtueshmërisë ligjore dhe faktorë të jashtëm. Bankat menaxhojnë riskun operacional përmes identifikimit të risqeve, duke përdorur analizimin e incidenteve historike, kryerjen e analizave të skenarëve, duke implementuar kontrolle të brendshme rigoroze, mekanizma raportimi dhe monitorimi, kornizave të riskut operacional, planifikimit të vazhdimësisë së biznesit, trajnimit të stafit dhe protokolleve të menaxhimit të incidenteve e investimeve të vazhdueshme në teknologjinë e e inovacionit<sup>(2)</sup>.

*Pajtueshmëria dhe risku ligjor.* Sipas Financial Stability Board (2017), pajtueshmëria dhe risku ligjor rrjedhin nga shkeljet e kërkesave rregullatore, ligjeve ose standardeve të industrisë, si dhe nga mosmarrëveshjet ligjore, proceset gjyqësore ose nga zbatimi i dispozitave detyruese të organeve ligjore kur gjenden në shkelje. Bankat përballen me pajtueshmërinë dhe risqet ligjore që lidhen me kundërpastrimit të parave, kërkesat e informacionit mbi klientin<sup>(3)</sup>, ligjet për mbrojtjen e konsumatorit, rregulloret për privatësinë e të dhënave dhe detyrime të tjera rregullatore. Pajtueshmëria dhe menaxhimi i riskut ligjor përfshijnë programe gjithëpërfshirëse të pajtueshmërisë, monitorim rregullator, këshillim ligjor dhe kontrolle të brendshme për të siguruar respektimin e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi

*Risku i reputacionit.* International Organization of Securities Commissions (2018), i referohet riskut të reputacionit si dëmtimi i mundshëm i reputacionit, markës ose imazhit publik të një banke që vjen nga nga perceptimet negative, vëmendja e publikut ose publiciteti negativ. Risku i reputacionit mund të lindë nga praktikatat e dobëta të biznesit, gabimet etike, sjelljet e pahijshme, ankesat e klientëve ose polemikat sociale. Pasojat e riskut të reputacionit përfshijnë humbjen e besimit të klientit, tkurrjen e vlerës së aseteve të aksionerëve, rritjen e kontrollit rregullator dhe vështirësinë në tërheqjen dhe mbajtjen e klientëve dhe talenteve. Menaxhimi efektiv i riskut të reputacionit, kërkon komunikim proaktiv, angazhim të palëve të interesit, gatishmëri ndaj krizës dhe respektim të standardeve etike dhe vlerave të korporatës

*Risku i normës së interesit.* Risku i normës së interesit i referohet ndikimeve të mundshme negative në të ardhurat neto nga interesi të bankës, vlerën ekonomike të kapitalit neto dhe ndryshimeve të bilancit ndaj ndryshimeve në normat e interesit. Bankat përballen me riskun e normës së interesit për shkak të luhatjeve në normat e interesit të tregut, që ndikojnë në çmimin e aktiveve, detyrimeve dhe marzheve neto të interesit. Menaxhimi efektiv i riskut të normës së interesit përfshin zbatimin e strategjive të menaxhimit të aktiveve dhe detyrimeve, mbrojtjen e ekspozimit ndaj luhatjeve të normave të interesit, përdorimin e derivateve të normës së interesit dhe analizimin e skenarëve të ndryshëm, për të vlerësuar ndikimin e ndryshimeve të normës së interesit në performancën financiare të bankës dhe profilin e riskut.

*Risku i sigurisë kibernetike.* Si një risk relativisht i ri i çerekshekullit të fundit, risku i sigurisë kibernetike përfshin kërcënimin e marrjes dhe rrjedhjes së të dhënave, aksesit të paautorëtzuar, sulmeve kibernetike ose ndërprerjeve në sistemet dhe infrastrukturën e TI, duke sjellë sfida të mëdha për operacionet e bankave, sigurinë e të dhënave të klientëve dhe stabilitetin financiar. Sulmet kibernetike mund të shkaktojnë vjedhje të informacionit, humbje financiare, ndërprerje operacionale dhe dëmtim të reputacionit [Yildirim, İsmail \(2018\)](#). Menaxhimi efektiv i riskut të sigurisë kibernetike kërkon masa të forta sigurie të TI-së, vlerësime të rregullta të cenueshmërisë së sistemit, trajnime të punonjësve, plane emergjence të reagimit ndaj incidenteve dhe bashkëpunim me partnerët e industrisë dhe autoritetet rregullatore, investime në inteligjencën artificiale, dhe teknologjitë e sigurisë kibernetike për të përmirësuar identifikimin e riskut, modelimin dhe proceset e vendimmarrjes duke përmirësuar efikasitetin dhe qendrueshmërinë [\(Federal Financial Institutions Examination Council, 2016\)](#).

*Risku strategjik.* Risku strategjik lind nga dështimet ose mospërshtatshmëria e strategjisë së biznesit të bankës, proceseve të vendimmarrjes ose aftësisë e zbatuese, duke çuar në mundësi të humbura,

2 ) Basel Committee on Banking Supervision. (2018). Principles for the sound management of operational risk. <https://www.bis.org/bcbs/publ/d403.htm>

3 ) Në anglisht “Anti money laundering” – AML dhe ‘know your client’ KYC

humbje të pjesës së tregut ose mospërputhje strategjike me vizionin e misionin e bankës. Bankat përballen me risqe strategjike që lidhen me ndryshimet në dinamikën e tregut, përparimet teknologjike, presionet konkurruese ose zhvillimet rregullatore. Menaxhimi efektiv i riskut strategjik përfshin identifikimin e riskut planifikimin strategjik, analizën e skenarit, inteligjencën konkurruese, vendimmarrjen e bazuar në risk, bashkëpunimin ndërfunksional dhe vlerësimin periodik të objektivave strategjike dhe treguesve kyç të vlerësimit të performancës për të garantuar përafrimin me qëllimet afatgjata të bankës dhe pritshmëritë e palëve të interesit.<sup>(4)</sup>

*Risku Mjedisor, Social, dhe i Qeverisjes (ESG)*<sup>(5)</sup>. Risku ESG përfshin faktorë të ndryshëm, duke përfshirë ndryshimin e klimës, degradimin e mjedisit, pabarazitë sociale, shkeljet e të drejtave të njeriut dhe dështimet e qeverisjes së bankave tregtare. Këto risqe mund të ndikojnë në reputacionin e bankës, efikasitetin operacional, pajtueshmërinë rregullatore dhe performancën financiare. Bankat përballen me trysni nga rregullatorët, investitorët dhe klientët, për të administruar risqet e ESG dhe për të integruar parimet e qendrueshmërisë në operacionet e tyre. Për të trajtuar risqet e ESG, bankat zbatojnë strategji, si praktikatat e përgjegjshme të huadhënies, iniciativat e financimit të gjelbër, portofolet e investimeve të qendrueshme dhe vlerësimet e riskut të ESG. Ata bashkëpunojnë me palët e interesit, duke përfshirë organizmat rregullatore, shoqatat e industrisë, OJQ-të dhe komunitetet, për të rritur transparencën, llogaridhënien dhe besimin e tyre. Për më tepër, bankat kryejnë kujdesin e duhur të ESG, përfshijnë kriteret e ESG në kornizat e menaxhimit të riskut dhe raportojnë mbi performancën e tyre të ESG palëve të interesit.<sup>(6)(7)</sup>

### 3 Metodologjia

Punimi bazohet në përshkrimin e fakteve të ndryshme që lidhen me Rrezikun në sistemin bankar në Shqipëri. Një peshë të madhe të punimit e zënë informacionet e përpunuara nga literatura mbi këtë fushë. Hulumtimi është i natyrës përshkruese për rreziqet. Analiza bazohet në analizën sasiore të statistikave bankare, kryesisht nga raporte vjetore të bankave të veçanta, Banka e Shqipërisë, ose referenca indirekte të saj nga Opendata dhe Shoqata Shqiptare e Bankave. Ato janë vendosur në grafikë për të treguar ecurinë e tregut të bankave tregtare në Shqipëri, për të kuptuar në çfarë mase kemi treg të mirë-administruar dhe me risk të moderuar. Gjithashtu, për 5 bankat kryesore tregtare shqiptare, pranë Departamentit të Riskut është shpërndarë një pyetësor për të grumbulluar të dhëna dhe kryerjen e një analize sasiore, për të evidentuar cilat janë risqet kryesore dhe si trajtohen ato nga bankat tregtare shqiptare dhe strategjitë kryesore që ndjekin ato për t'i minimizuar këto risqe. Në shtojcë, jepet përmbajtja e pyetësorit, ndërsa tek analiza e rezultateve, prezantohen gjetjet.

### 4 Analiza e të dhënave


Bazuar në analizën e të dhënave të marra nga AAB është ndërtuar grafiku në vijim I cili tregon një ecuri impresionuese për normën e kredive të këqija prej 2016 në 2023, si në vijim:

4 () <https://www.inscribe.ai/financial-risk-management/how-banks-manage-risks> - vizituar 16 shkurt 2024

5 () Shkurtim nga anglishtja për “Environmental, Social, Governance”, ESG

6 () Financial Stability Board. (2017). Recommendations of the Task Force on Climate-related Financial Disclosures.

7 () <https://assets.bbhub.io/company/sites/60/2021/10/FINAL-2017-TCFD-Report.pdf> - shkarkuar 16 shkurt 2024

**Grafiku 2** Kreditë e këqija kundrejt kreditit gjithsej

**Burimi:** AAB, Shoqata e bankave shqiptare, shkarkuar 16 02.02024, tabela nga autorët

Referuar IORWG (International Organization Risk Working Group) konkludojmë se Banka e Shqipërisë ka arritur një pozicion të mirë në vlerësimin e riskut operacional (me një rezultat prej 84.45%, nga 76.1% në periudhën pararendëse 5-vjeçare të vlerësimit). BSH iu bashkua kësaj organizate në vitin 2015<sup>(8)</sup>

**Tabela 3** Vlerësimi i riskut operacional për BSH (IORWG 2022)<sup>(9)</sup>

AD-HOC	BASIC	MANAGED	ADVANCED	MATURED
<61%	≥61%	≥69%	≥86%	≥94%

**Burimi :** Raporti Vjetor i BSH 2022, kapitulli 5, fq 112

Në tabelën në vijim janë paraqitur në mënyrë agregate të dhënat e tregut bankar për disa indikator.

**Tabela 4** Të dhëna të përgjithshme për sektorin bankar

No	INDICATOR	in mil ALL
1	Total assets	1,965,275.66
2	Total loans	739,491.00
	2.1 Retail loans	273,101.49
	2.2 Corporate loans	466,389.51
3	Total deposits	1,605,179.92
	3.1 Retail deposits	1,245,592.68
	3.2 Corporate deposits	359,587.24
4	Profit (net, cumulative)	32,483
5	Equity Capital	195,389
6	Capital adequacy (%)	19.63
7	ROE (%)	17.26
8	ROA (%)	1.72
9	Problem loans/Total loans Ratio (%)	4.74

Raporti Statistikor - nëntor 2023 i BSH tregon që Bankat shqiptare gjenerojnë rreth 21% të fitimit

8 () [https://www.bankofalbania.org/rc/doc/5\\_THE\\_OPERATIONAL\\_RISK\\_MANAGEMENT\\_24644.pdf](https://www.bankofalbania.org/rc/doc/5_THE_OPERATIONAL_RISK_MANAGEMENT_24644.pdf) - shkarkuar 16 shkurt 2023

9 () International Organization Risk Working Group

neto nga jo-interesi, ndërsa 79% e fitimit të tyre vjen nga shërbimet që gjenerojnë interes, ku edhe risku i ekspozimit është më i madh, sepse na këtë kategori futen gjithë aktivitetet e huadhënies e kreditimit. Nga ana tjetër, vihet re një gati dyfishim i të ardhurave prej jo-interesave, si një ndikim direkt i ritjes së pagesave online.

**Tabela 5** Të ardhurat dhe shpenzimet e sektorit bankar për qershor 2022-2023 (mld lekë)

	Qershor 2023			Qershor 2022
	Në lekë	Në valutë	Total	Total
Të ardhura nga interesat	20.7	18.8	39.5	28.8
Shpenzime për interesat	4.3	2	6.3	4.1
Të ardhura neto nga interesat	16.4	16.8	33.2	24.7
Të ardhura neto jo nga interesat	4.7	2.4	7.1	1.9
gjoba dhe komisione	3.8	3.8	7.7	7.2
humbje ose fitim nga instrumentet financiare	0.6	-1.5	-0.9	-6.3
Shpenzime jo për interesa	16.4	5	21.4	19.2
Provizjione (neto)	1.8	0.3	2.1	0.2
për kreditë	2.2	0.7	2.9	1.3
për mjete të tjera financiare	-0.4	-0.4	-0.8	-1.0
Zëra të jashtëzakonshëm	-0.3	-0.1	-0.4	-0.6
Taksa mbi të ardhurat	2.5	0	2.5	1.3

### Burimi: Banka e Shqipërisë - Raporti i stabilitetit financiar 6 mujori 1-2023

Fakti që kreditë me probleme janë në rënie të vazhdueshme (sipas raportimit Mars 2024, ky raport është rreth 4.6%) është një tregues i mirë për një risk më të moderuar të ekspozimit. Ky është niveli më i ulët i dekadës së fundit. Ndërkohë, sipas po të njëjtit raport, rreth 36 % e kredive shkon për individë, ndërsa 61% shkon për biznese.

Ndërsa tabela në vijim ka të dhëna për ecurinë e kredisë sipas afatit, sektorit dhe valutës

**Tabela 6** Ecuria e kredisë sipas afatit, sektorit dhe valutës

	Mld lekë	Pesha (%)		Ndryshimi (%)	
	06/23	06/23	06/22	6-mujor	vjetor
Lek	365	51	49	5	6
Valutë	348	49	51	-5	-2
Sektori publik	19	3	4	-23	-26
Biznese	433	61	63	-1	0
Individë	260	36	33	4	8
Afatshkurtër	185	26	25	-3	5
Afatmesme	95	13	14	1	-4
Afatgjatë	433	61	61	1	2
Kredia	713	100	100	0	2

### Burimi: Banka e Shqipërisë <sup>(10)</sup>

10 () BSH, Raporti i stabilitetit financiar 6m1-2023

Sipas rezultateve të pyetësorit 1, bankat kryesore tregtare shqiptare, identifikojnë si risqe kryesore: Riskun e kredisë (RK), Riskun e pajtueshmërisë dhe atë ligjor (RPL), Riskun e reputacionit (RR), dhe Riskun strategjik (RS). Rezultatet jepen në tabelat më poshtë:

**Tabela 7** Rezultatet e anketimit të 5 bankave tregtare më të mëdha shqiptare

	Risku Kredisë	Risku Tregtar	Risku Likuiditetit	Risku Operacional	Risku Pajtueshmërisë e Ligjor	Risku Reputacionit	Risku Sigurisë Informacionit	Risku Normës Interesit	Risku Strategjik	Risku Mjedisit Shoqërisë Qeverisjes
Banka 1	5	4	4	3.5	5	4.5	4	4	5	4
Banka 2	5	3.5	4	4.5	5	5	4.5	4.5	5	4
Banka 3	4.5	4.5	4	4	5	4.5	4.5	4	4	4.5
Banka 4	5	4	4.5	4	5	4.5	4	4	4	3.5
Banka 5	4.5	4	4	3.5	5	4.5	5	4.5	4.5	4.5

Risku i kredisë dhe ai i reputacionit, konsiderohen si më të rëndësishmit me 4.8 dhe 4.6 përkatësisht, ndërkohë që risku operacional dhe ai tregtar vlerësohen me 4.0 dhe 3.9 pikë

**Tabela 8** Rezultatet e mesatares së anketimit të 5 bankave tregtare më të mëdha shqiptare

Vlerat mesatare për bankat	1	2	3	4	5	
Në një shkallë nga 1 deri në 5, sa të rëndësishëm e vlerësoni <i>riskun e kredisë</i> për bankën tuaj?						4.8
Si do ta vlerësonit ndjeshmërinë e bankës suaj ndaj <i>riskut tregtar</i> ?						4.0
Sipas mendimit tuaj, sa i rëndësishëm është <i>risku i likuiditetit</i> për bankën tuaj?						4.1
Si e konsideroni <i>riskun operacional</i> për bankën tuaj?						3.9
Ju lutem vlerësoni rëndësinë e <i>riskut të pajtueshmërisë dhe atij ligjor</i> për bankën tuaj.						5.0
Si e perceptoni <i>riskun e reputacionit</i> në bankën tuaj?						4.6
Sa kritik mendoni se është <i>risku i sigurisë së informacionit</i> për bankën tuaj?						4.4
Vlerësoni rëndësinë e <i>riskut të normës së interesit</i> për bankën tuaj.						4.2
Në mendimin tuaj, si shihet <i>risku strategjik</i> në bankën tuaj?						4.5
Si e percepton banka juaj <i>riskun e mjedisit, shoqërisë dhe qeverisjes</i> ?						4.1

Pas identifikimit të 4 risqeve që prceptohen më me ndikim, bankat u anketuan për 1-2 strategji kryesore që ato ndiqnin për të minimizuar secilin nga këto risqe.

Rezultatet jepen në tabelën 9

**Tabela 9** *Strategjitë kryesore të ndjekura nga bankat për minimizimin e 4 risqeve*

Banka/Risku	RK	RPL	RR	RS
Banka 1	Diversifikim Portofoli	Rregullore të brendshme	Praktika etike të biznesit	Planifikim skenarësh /mbikqyrje strategjike
Banka 2	Diversifikim Portofoli	Rregullore të brendshme	Praktika etike të biznesit	Planifikim skenarësh /mbikqyrje strategjike/rritje transparence
Banka 3	Diversifikim Portofoli	Rregullore të brendshme	Praktika etike të biznesit	Planifikim skenarësh /mbikqyrje strategjike/rritje transparence
Banka 4	Diversifikim Portofoli	Rregullore të brendshme/kës hillim të jashtëm	Praktika etike të biznesit	Forcimi i qeverisjes dhe vendimmarrjes/mbikqyrje strategjike
Banka 5	Diversifikim Portofoli	Rregullore të brendshme	Praktika etike të biznesit/Angazhim me palët e interesit	Forcimi i qeverisjes dhe vendimmarrjes/mbikqyrje strategjike

Tabela 9 tregon që diversifikimi i portofolit , rregullore të forta të brendshme , praktika etike të biznesit dhe planifikim skenarësh e mbikqyrje strategjike, konsiderohen si mënyrat më efektive në minimizimin e 4 risqeve kryesore sipas tyre.

## 5 Përfundime

5 bankat më të mëdha në Shqipëri identifikojnë 4 risqet, si në vijim: *Riskun e kredisë, Riskun e pajtueshmërisë dhe atë ligjor, Riskun e reputacionit, dhe Riskun strategjik (RS)*. Si strategji kryesore ato ndjekin: *Diversifikimi i portofolit , Rregullore të forta të brendshme, Praktika etike të biznesit dhe Planifikim skenarësh e Mbikqyrje strategjike*. Rekomandohet forcimi strukturave të menaxhimit të rrezikut, 3 linjat e mbrojtjes dhe sidomos mbikëqyrja me bazë rrezikun e aplikuar nga Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti Mbikëqyrjes Financiare.

## Referenca

- Allen, L., & Saunders, A. (2011). Credit risk management in and out of the financial crisis: New approaches to value at risk and other paradigms. *Journal of Banking & Finance*, 35(10), 2473-2484.
- Amaravadi, C. S., Shafer, W. M., & Wan, G. (2021). Cybersecurity Risk Management and the Banking Industry: A Literature Review and Research Agenda. *Journal of Management Information Systems*, 38(2), 606-643.
- Barth, J. R., Lin, C., Ma, Y., Seade, J., & Song, F. M. (2013). Do bank regulation, supervision and monitoring enhance or impede bank efficiency? *Journal of Banking & Finance*, 37(8), 2879-2892. [10.1016/j.jbankfin.2013.04.030](https://doi.org/10.1016/j.jbankfin.2013.04.030)
- Gündüz, Y., & Kaya, H. (2018). Liquidity risk, credit risk, and market risk: Their interactions and the role of financial regulation. *Journal of Financial Stability*, 36, 257-275
- Oet, M. V., Eiben, R., & Bianco, T. (2018). Bank stress testing: Public interest or regulatory capture? *Journal of Financial Stability*, 39, 37-50.

6. Hull, J. C. (2015). Risk management and financial institutions. John Wiley & Sons.
7. Li, H., Sun, J., & Shan, J. (2010). The impact of operational risk management on bank performance: Evidence from China's banking industry. *International Journal of Risk Assessment and Management*, 14(1-2), 143-156. <https://doi.org/10.1504/IJRAM.2010.032501>
8. Stiroh, K.J. New Evidence on the Determinants of Bank Risk. *J Finan Serv Res* 30, 237–263 (2006). <https://doi.org/10.1007/s10693-006-0418-5>
9. Yıldırım, İsmail. (2018). Cyber Risk Management in Banks: Cyber Risk Insurance-Bankalarda Siber Risklerin Yönetimi: Siber Risk Sigortası. DOI:10.4018/978-1-5225-5927-6.ch003.
10. Basel Committee on Banking Supervision. (2020). Basel III: Finalizing post-crisis reforms. Bank for International Settlements.
11. Basel Committee on Banking Supervision. (2018). Principles for the sound management of operational risk. <https://www.bis.org/bcbs/publ/d403.htm>
12. [https://www.bis.org/basel\\_framework/index.htm](https://www.bis.org/basel_framework/index.htm)
13. The future of bank risk management | McKinsey 2016 <https://www.mckinsey.com/capabilities/risk-and-resilience/our-insights/the-future-of-bank-risk-management>

## 7 Shtojcë

### Pyetësori

- Në një shkallë nga 1 deri në 5, sa të rëndësishëm e vlerësoni **riskun e kredisë** për bankën tuaj? (1 = i parëndësishëm, 5 = shumë i rëndësishëm)
- Si do ta vlerësonit ndjeshmërinë e bankës suaj ndaj **riskut tregtar**? (1 = aspak e ndjeshme, 5 = shumë e ndjeshme)
- Sipas mendimit tuaj, sa i rëndësishëm është **risku i likuiditetit** për bankën tuaj? (1 = i parëndësishëm, 5 = shumë i rëndësishëm)
- Si e konsideroni **riskun operacional** për bankën tuaj? (1 = të ulët, 5 = të lartë)
- Ju lutem vlerësoni rëndësinë e **riskut të pajtueshmërisë dhe atij ligjor** për bankën tuaj. (1 = i parëndësishëm, 5 = shumë i rëndësishëm)
- Si e perceptoni **riskun e reputacionit** në bankën tuaj? (1 = i parëndësishëm, 5 = shumë i rëndësishëm)
- Sa kritik mendoni se është **risku i sigurisë së informacionit** për bankën tuaj? (1 = jo kritik, 5 = shumë kritik)
- Vlerësoni rëndësinë e **riskut të normës së interesit** për bankën tuaj. (1 = jo e rëndësishme, 5 = shumë e rëndësishme)
- Në mendimin tuaj, si shihet **risku strategjik** në bankën tuaj? (1 = si i parëndësishëm, 5 = si shumë i rëndësishëm)
- Si e percepton banka juaj **riskun e mjedisit, shoqërisë dhe qeverisjes**? (1 = të parëndësishëm, 5 = shumë të rëndësishëm)

NB: Njësia më e vogël = 0.5

RK – Risku i kredisë

RPL – Risku i pasjtueshmërisë dhe atij ligjor

RR – Risku reputacionit

## RS – Risku strategjik

Banka/Risku	RK	RPL	RR	RS
Banka 1	Diversifikim Portofoli	Rregullore të brendshme	Praktika etike të biznesit	Planifikim skenarësh /mbikqyrje strategjike
Banka 2	Diversifikim Portofoli	Rregullore të brendshme	Praktika etike të biznesit	Planifikim skenarësh /mbikqyrje strategjike/ritje transparence
Banka 3	Diversifikim Portofoli	Rregullore të brendshme/këshillim të jashtëm	Praktika etike të biznesit	Planifikim skenarësh /mbikqyrje strategjike/ritje transparence
Banka 4	Diversifikim Portofoli	Rregullore të brendshme/këshillim të jashtëm	Praktika etike të biznesit	Forcim i qeverisjes dhe vendimmartjes/mbikqyrje strategjike
Banka 5	Diversifikim Portofoli	Rregullore të brendshme	Praktika etike të biznesit/Angazhim me palët e interesit	Forcim i qeverisjes dhe vendimmartjes/mbikqyrje strategjike